



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	24/12/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Fehmi REKA Udhëheqës i Zyrës së Ë në Komunën e Ferizajt
CC:	z. Agim ALIU Kryetar i Komunës së Ferizajt
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Asfaltimi i rrugës në fshatin Varosh- lagjet "Hetaj" dhe "Kurtaliqi" dhe asfaltimi i rrugës në fshatin pleshinë e Epërme – lagjia " Bajraktari "



I nderuari z. Reka ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Asfaltimi i rrugës në fshatin Varosh- lagjet "Hetaj" dhe "Kurtaliqi" dhe asfaltimi i rrugës në fshatin pleshinë e Epërme – lagjia " Bajraktari ", me nr. Prokurimi : 656 13 518 521 në Komunën e Ferizajt, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin për tenderin "Asfaltimi i rrugës në fshatin Varosh- lagjet "Hetaj" dhe "Kurtaliqi" dhe asfaltimi i rrugës në fshatin pleshinë e Epërme – lagjia " Bajraktari ", me nr.

Prokurimi : 656 13 518 521 në Komunën e Ferizajt, i inicuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Ferizajt. Gjatë monitorimit të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit me që vetëm një OE pjesëmarrës është i përgjegjshëm dhe plotëson kriteret të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Komunën e Ferizajt, më datë 30/10/2013 përmes faqes elektronike të KRPP-së publikoi “ Njoftimin për Kontratë ” për këtë aktivitet të lidhje me tenderin me titull “ **Asfaltimi i rrugës në fshatin Varosh- lagjet “ Hetaj” dhe “ Kurtaliqi “ dhe asfaltimi i rrugës në fshatin pleshinë e Epërme – lagjia “ Bajraktari “**, me nr. Prokurimi : 656 13 518 521 në Komunën e Ferizajt.

Për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 9 Operator Ekonomik ndërsa 4 Operator i kanë dorëzuar ofertat e tyre për këtë tender .

Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Ferizajt që të jetë pjesë e monitorimit për tenderin me titull “ Asfaltimi i rrugës në fshatin Varosh- lagjet “ Hetaj” dhe “ Kurtaliqi “ dhe asfaltimi i rrugës në fshatin pleshinë e Epërme – lagjia “ Bajraktari “. Gjatë monitorimit të këtij aktiviteti të prokurimit është Konstatuar se vetëm një Operator Ekonomik është i përgjegjshëm dhe i përmbushë kërkesat të cilat janë përshkruar në “ Njoftimin për Kontratë “ dhe “ Dosjen e Tenderit “ që ka përgatitë Autoriteti Kontraktues për këtë tender .

Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve pas vlerësimit të ofertave të të gjithë Operatorëve Ekonomik që kanë ofertuar për këtë tender konstatoi dhe erdhi në përfundim se vetëm një Operator Ekonomik është i përgjegjshëm dhe me këtë rekomandoi anulimin e këtij aktiviteti të Prokurimit Publik.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !